



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVAT**  
**PËRMBARUESI GJYQËSOR “LEKË DODAJ”**

Adr: Rr. “Astrit Balluku”, Nd. 2, H. 25, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, E-mail: [leke\\_dodaj@hotmail.com](mailto:leke_dodaj@hotmail.com), Cel: +355 67 39 00 666

**Nr. 501 /Prot; 225 - Regj**

**Tiranë, më 09 / 05/ 2022**

**Lënda :** Kërkohet regjistrimi i Vendimit për Kalimin në Pronësi të sendit të luajtshëm me nr. 368/prot; 225-Regj, datë 07.04.2022.

**Drejtuar :** Qendrës Kombëtare të Biznesit  
Bulevardi Zhan D’Ark , Tiranë

**Për dijeni :** Dorëzanësit, **Milazim Kabashi**  
Lagjia e Re, pranë Xhamisë, Shkallnur, Durrës

**Pala Debitore Shoqëria “ADNAIN” sh.p.k me NIPT K01608501Q**  
Njësia Bashkiake nr.5, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake,  
Kulla, nr.2, Kati 4, Zyra A1, Tiranë.

**Palës Kreditore, Bardhyl Mara, përfaqësuar me Prokurë të**  
**Posacme me nr.5321 Re, nr.3536 Kol nga Z.Shyqyri Ahmeti.**  
Rruga “Pavarësia “Durrës

**Blerësit , Z.Bledar Vorpsi**  
Rruga “ Kodra e Diellit” banesë private nr.064, Tiranë

**Të nderuar Zotërinj,**

Pranë Shërbimit Përmbarimor të Përmbaruesit Gjyqësor Lekë Dodaj, me kërkesën e Palës Kreditore Bardhyl Mara është regjistruar Titulli Ekzekutiv Deklaratë Noteriale, nr.2499 Rep, nr.843 Kol, datë 17.06.2013, redaktuar nga Notere Flutura Abdiu për të cilin është lëshuar për zbatim Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi nr.(11-2014-)1050, datë 24.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në ngarkim të Palës Debitore Shoqëria “ADNAIN” sh.p.k me NIPT K01608501Q dhe në cilësinë e Dorëzanësit Milazim Kabashi, për të cilën ju sqarojmë se :

Nga veprimet proceduriale të kryera për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, më datë 06.04.2022, ora 13:00 është zhvilluar Ankandi i Dytë për pasurinë e luajtshme kuota të kapitalit në vlerën prej 2% që zotëroreshin nga ana e Dorëzanësit Milazim Kabashi në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q, e cila ka si objekt të saj ndërtime civile dhe industriale si dhe investime në TEC dhe HEC , me seli qëndrore të ndodhur në Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla, nr.2, Kati 4, Zyra A1, Njësia Bashkiake nr.5, Tiranë , të cilat dolën në shitje në Ankandin e Dytë, për vlerën e detyrimit në masën 6’978’982.9 ( gjashtë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy pikë nëntë) Lekë, nga ku u shpall fitues , Ofertuesi Bledar Vorpsi, i biri i Rakipit, i datëlindjes 22.06.1971 i identifikuar me Letërnjoftimin nr.032399843 dhe numër personal H10622146K , pasi ka paguar menjëherë vlerën e sendit.

Në vijmësi të procedurave përmbarrimore dhe në zbatim të nenit 556, 557, 558 dhe 559 të K.Pr.Civile, Shërbimi Përmbarrimor me shkresën me nr. 368/prot; 225-Regj të datës 07.02.2022 ka kërkuar nga ana e Institucionit Tuaj , kalimin e pronësisë të kuotave të kapitalit në vlerën prej 2% që zotëroreshin nga pronar i mëparshëm Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963, i cili ishte në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q, në emër të blerësit fitues të ankandit të datës 06.04.2022, Z. Bledar Rakip Vorpsi, i datëlindjes 22.06.1971.

Nga ana e Institucionit Tuaj , me shkresën me nr. 9581/1 prot të datës 12.04.2022 , është bërë me dije Shërbimi Përmbarrimor se në mënyrë që Institucioni Juaj të depozitohet shkresën me nr.368/prot, datë 07.02.2022 , për kalimin e pronësisë të kuotave të kapitalit në vlerën prej 2 % , që zotërohen nga pronari i mëparshëm Milazim Kabashi, duhet të depozitohet shkresa nga Zyra Përmbarrimore “DIT” me Përmbarruese Gjyqësore “Suela Methoxha”, për heqjen e sekuestros ose lejimin e kalimit të pronësisë të kuotave të zotëruara nga Dorëzanësi Milazim Kabashi, shkresë e cila ju është komunikuar nga ana e Zyrës Përmbarrimore “DIT” të Përmbarrueses Gjyqësore Suela Methoxha me nr. 130/prot të datës 28.04.2022, dhe të cilën Institucioni Juaj e ka marrë në dorëzim, nga ku është pasqyruar në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar në të dhënat e Shoqërisë “ADNAIN” sh.p.k me NIPT K01608501Q : “ *Depozitimin e urdhërit me nr.49-Regj, nr.130 prot, datë 28.04.2022 , të lëshuar nga Zyra Përmbarrimore “DIT” me Përmbarruese Gjyqësore “Suela Methoxha” protokolluar pranë Q.K.B me nr.12271 /prot , datë 29.04.2022 , ku është urdhëruar : Heqja e masës së sekuestros konservative në aksionet që zotërohen nga debitori Milazim Kabashi në Shoqërinë “ADNAIN” sh.p.k me NUIS (NIPT) K01608501Q. “*

Për sa më sipër, të ndodhur në kushtet kur nga ana e Zyrës Përmbarrimore “ DIT” me Përmbarruese Gjyqësore Suela Methoxha, është hequr masa e sekuestros e kuotave të kapitalit në vlerën prej 2% që zotëroreshin nga ana e Dorëzanësit Milazim Kabashi në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q, kërkojmë

nga ana e Institucionit Tuaj, regjistrimin e Vendimit për Kalimin në Pronësi të sendit të luajtshëm me nr. 368/prot; 225-Regj, datë 07.04.2022 , për kuotat e kapitalit në vlerën prej 2% që zotëroheshin nga ana e Dorëzanësit Milazim Kabashi në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q, në emër të blerësit fitues të ankandit të datës 06.04.2022, Z. Bledar Vorpsi, i biri i Rakipit, i datëlindjes 22.06.1971 i identifikuar me Letërnjoftimin nr.032399843 dhe numër personal H10622146K .

**Bashkëlidhur :**

- Vendimi për kalimin e sendit të luajtshëm në pronësi me nr.368/prot; 225-Regj, datë 07.04.2022, së bashku me urdhërin për heqjen e masës së sekuestros konservative me nr. 369prot; 225-Regj, datë 07.04.2022.
- Kthim –Përgjigja e Institucionit Tuaj, me nr. 9581/1 prot, datë 12.04.2022.
- Urdhëri për heqjen e masës së sekuestros konservative nga Zyra Përmbarimore “DIT” nga Përmbaruesja Gjyqësore Suela Methoxha, me nr, 130- Regj, datë 28.04.2022 , së bashku me letër-lajmërimin e marrjes dijeni nga ana Juaj.
- Fotkopje e Kartës së ID të blerësit fitues Z. Bledar Vorpsi.

**Duke ju falenderuar bashkëpunimin, mbetemi në pritje të veprimeve Tuaja.**

**Me respekt,**

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**LEKË D. DODAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVAT  
PËRMBARUESI GJYQËSOR "LEKË DODAJ"

Adr: Rr. "Astrit Balluku", Nd. 2, H. 25, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, E-mail: [leke\\_dodaj@hotmail.com](mailto:leke_dodaj@hotmail.com), Cel: +355 67 39 00 666

Nr. 368 /Prot; 225– Regj

Tiranë më, 07 / 04 / 2022

**V E N D I M**  
**PËR KALIM SENDI TË LUAJTSHËM NË PRONËSI**

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit, Tiranë

Për dijëni : Dorëzanësit, Milazim Kabashi  
Lagjia e Re, pranë Xhamisë, Shkallnur, Durrës

**Pala Debitore Shoqëria "ADNAIN" sh.p.k me NIPT K01608501Q**  
Njësia Bashkiake nr.5, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake,  
Kulla, nr.2, Kati 4, Zyra A1, Tiranë.

**Palës Kreditore, Bardhyl Mara, përfaqësuar me Prokurë të**  
**Posacme me nr.5321 Re, nr.3536 Kol nga Z.Shyqyri Ahmeti.**  
Rruga "Pavarësia "Durrës

**Blerësit , Z.Bledar Vorpsi**  
Rruga " Kodra e Diellit" banesë private nr.064, Tiranë



**Në Tiranë , sot më 07.04.2022.**

Unë, Lekë Dodaj Përmbartes Gjyqësor Privat me Çertifikatë Nr.144 Mars 2013 dhe NIPT L31603014T, bazuar në Titullin Ekzekutiv Deklaratë Noteriale, nr.2499 Rep, nr.843 Kol, datë 17.06.2013, redaktuar nga Notere Flutura Abdiu për të cilin është lëshuar për zbatim Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi nr.(11-2014-)1050, datë 24.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës,

**KONSTATOVA :**

Se me datë 24.04.2016, është depozituar pranë Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Lekë Dodaj kërkesa e Palës Kreditore Bardhyl Mara, së bashku me Titullin Ekzekutiv Deklaratë Noteriale, nr.2499 Rep, nr.843 Kol, datë 17.06.2013, redaktuar nga Notere Flutura Abdiu për të cilin është lëshuar për zbatim Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi nr. (11-2014-)1050, datë 24.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me palë dhe objekt :

**Kreditor : Bardhyl Mara**  
**Debitor : Shoqëria "ADNAIN" sh.p.k me NIPT K01608501Q**  
**Dorëzanës : Milazim Kabashi**  
**Objekti : Kthim shume**

Në zbatim të Titullit të Ekzekutimit të sipërcituar, nga ana e Shërbimit Përmbarimor janë kryer një sër veprimesh proceduriale për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv duke u lajmëruar fillimisht Pala Debitore Shoqëria "ADNAIN" sh.p.k me NIPT K01608501Q dhe Dorëzanësi Milazim Kabashi, për shlyerjen e detyrimit financiar në mënyrë vullnetare.

Të ndodhur në kushtet kur Pala Debitore Shoqëria "ADNAIN" sh.p.k me NIPT K01608501Q dhe Dorëzanësi Milazim Kabashi, nuk e kanë përmbushur detyrimin brenda afatit të përcaktuar në nenin 517 të K.Pr.Civile dhe konform nenit 519 të K.Pr.Civile, Titulli Ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe nga ana e Shërbimit Përmbarimor bazuar në nenin 527 të K.Pr.Civile është vendosur masa e sekuestros konservative mbi 2% e kuotave të kapitalit që zotëron Dorëzanësi Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963, në Shoqërinë ADNAIN sh.p.k me NIPT K01608501Q.

Në vijimësi të procedurave përmbarimore dhe në zbatim të nenit 552 të K.Pr.Civile, Shërbimi Përmbarimor ka njoftuar palët në proces ekzekutimi ( debitor-dorëzanës-kreditor) dhe u ka kërkuar arritjen e një marrëveshje për caktimin e vlerës së sendit të sekuestruar të sipërcituar, brenda afatit ligjor 7(shtatë) ditor.

Nga ana e palëve nuk është depozituar asnjë marrëveshje me shkrim për caktimin e çmimit të sendit të sekuestruar me mirëkuptim dhe të ndodhur në këto kushte në zbatim të nenit 552 të K.Pr.Civile, Shërbimi Përmbarimor ka caktuar Eksperten Kontabël Audituesen Ligjore të Liçensuar Znj. Shpresa Breçani me nr. Liçense 143, Regjistruar më datë 29.06.2005 me NIPT K71529023K, për vlerësimin e kuotave të kapitalit në vlerën prej 2% që zotëron Dorëzanësi Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963, në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q.

Ekspertja e Liçensuar Kontabël Audituesja Ligjore më datë 14.05.2021, ka paraqitur pranë Shërbimit Përmbarimor Raport-Vlerësimin mbi pasurinë e luajtshme të sipërcituar, i cili ju është komunikuar palëve në proces dhe bazuar në nenin 549 të K.Pr.Civile, Shërbimi Përmbarimor ka nisur në mënyrë të përsëritur në drejtim të Dorëzanësit Milazim Kabashi, njoftimin për shlyerje detyrimi, por nga Shërbimi Postar, njoftimet janë kthyer të pakomunikuara me shënimet "Objekt i pakërkuar, nuk ndodhet në adresë" apo i " I panjohur, Adresë e Shkurtër.

Të ndodhur në kushtet kur Dorëzanësi Milazim Kabashi nuk ka marrë dijëni në asnjë nga njoftimet e nisura në drejtim të tij dhe bazuar në nenin 522 e vijues të K.Pr.Civile, Shërbimi Përmbarrimor i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën me objekt caktimin e një Përfaqësuesi Ligjor për Dorëzanësin Milazim Sadri Kabashi, për të bërë të mundur vazhdimin e procedurave përmbarrimore për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv.

Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, është caktuar seanca gjyqësore më datë 14.02.2022, ora 12:00, në të cilën ishte i pranishëm Dorëzanësi Milazim Kabashi dhe nga ana e Shërbimit Përmbarrimor i është vënë në dispozicion në seancën gjyqësore Dorëzanësit Milazim Kabashi njoftimi për përmbushje detyrimi nr. 698/prot; 225-Regj i datës 15.06.2021, i cili refuzoi të merrte njoftimin, nga ku gjykata e pasqyrtoi veprimin e tij në procesverbalin e seancës dhe e konsideroi njoftimin të kryer.

**Për sa më sipër , të ndodhur në kushtet kur Dorëzanësi Milazim Kabashi ka marrë dijëni lidhur me njoftimin për shlyerje detyrimi, por nuk e ka përmbushur detyrimin financiar brënda afatit të përcaktuar në nenin 549 të K.Pr.Civile, si dhe të ndodhur në kushtet kur sendi i luajtshëm i sekuestruar i kuotave të kapitalit në vlerën prej 2% që zotëron Dorëzanësi Milazim Sadri Kabashi në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q, për shkak të natyrës dhe të gjëndjes së tij nuk mund të pranohej në shitje të lirë, Shërbimi Përmbarrimor i Përmbarruesit Gjyqësor Lekë Dodaj me shkresën me nr.219/prot; 225-Regj të datës 07.03.2022 mori vendim për shpalljen e Ankandit të Parë.**

Në Ankandin e Parë të zhvilluar më datë 17.03.2022 për shitjen e pasurisë së luajtshme Kuota të kapitalit në vlerën prej 2% që zotërohen nga Dorëzanësi Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963, i cili është në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q, e cila ka si objekt të saj ndërtime civile dhe industriale si dhe investime në TEC dhe HEC , me seli qëndrore të ndodhur në Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla, nr.2, Kati 4, Zyra A1, Njësia Bashkiake nr.5, Tiranë, nuk u paraqit asnjë ofertues dhe bazuar në nenin 557 të K.Pr.Civile, me shkresën me nr.315/prot; 225-Regj, të datës 28.03.2022 Përmbarruesi Gjyqësor caktoi çmimin e ri për sendin e luajtshëm të sipërcituar , jo më të ulët se 30% të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë dhe bëri shpalljen e ankandit të dytë , nga ku njoftimi për shpalljen e ankandit është afishuar në të gjitha vendet e parashikuara në nenin 555 të K.Pr.Civile.

**Po ashtu, janë njoftuar për shpalljen dhe zhvillimin e Ankandit të Dytë për pasurinë e luajtshme , Pala Debitore Shoqëria “ADNAIN” sh.p.k me NIPT K01608501Q, Pala Kreditore Bardhyl Mara, të cilët kanë marrë dijëni në mënyrë të rregullt**

konfirmuar nga letër-lajmërimi përkatës, ndërsa Dorëzanësi Milazim Kabashi ka refuzuar marrjen e njoftimit për shpalljen e Ankandit të Dytë me nr. 315 /prot 225-Regj të datës 28.03.2022.

Në Ankandin e Dytë që u zhvillua më datë 06.04.2022, ora 13:00 u paraqit Ofertuesi Bledar Rakip Vorpsi i datëlindjes 22.06.1971 i identifikuar me letërnjoftimin nr. H10622146K i cili dha ofertën përfundimtare në vlerën 7'000'000 ( shtatë milionë) Lekë për sendin e luajtshëm kuota të kapitalit në vlerën prej 2% që zotërohen nga Dorëzanësi Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963, i cili është në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q, e cila ka si objekt të saj ndërtime civile dhe industriale si dhe investime në TEC dhe HEC , me seli qëndrore të ndodhur në Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla, nr.2, Kati 4, Zyra A1, Njësia Bashkiake nr.5, Tiranë.

Ofertuesi Bledar Rakip Vorpsi , u shpall fitues për sendin e luajtshëm të sipërcituar dhe të ndodhur në këto kushte, në zbatim të nenit 556, 557, 558 dhe 559 të K.Pr.Civile,

#### V E N D O S A :

**I.Kalimin e Pronësisë të kuotave të kapitalit në vlerën prej 2% që zotërohen nga pronar i mëparshëm Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963, i cili është në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q, e cila ka si objekt të saj ndërtime civile dhe industriale si dhe investime në TEC dhe HEC , me seli qëndrore të ndodhur në Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla, nr.2, Kati 4, Zyra A1, Njësia Bashkiake nr.5, Tiranë, në emër të blerësit fitues të ankandit të datës 06.04.2022, Z. Bledar Vorpsi, i biri i Rakipit, i datëlindjes 22.06.1971, i identifikuar me Letërnjoftimin nr.032399843 dhe numër personal H10622146, pasi ka paguar menjëherë vlerën e sendit.**

**-Kuotat e kapitalit në vlerën prej 2 % të sipërcituara , u shitën për shumën 7'000'000 (shtatë milion ) Lekë .**

**-Shtetasi Bledar Rakip Vorpsi i datëlindjes 22.06.1971 , fiton nga kjo ditë të gjitha të drejtat që kishte mbi sendin e luajtshëm të kapitalit në vlerën prej 2% Dorëzanësi Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963.**

**II.Çdo shënim dhe masë sekuestro të vendosura nga ana ime, për sendin e luajtshëm të kuotave të kapitalit në vlerën prej 2%, hiqen.**

III. Detyrimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, të bëjë regjistrimin e aktit të përmbaruesit gjyqësor nr.368/ prot, 225-Regj të datës 07.04.2022, për kalim sendi të luajtshëm në pronësi, sipas neneve 556, 557, 559 të K.Pr.Civile, duke bërë ndryshimet përkatëse, kundrejt tarifave përkatëse, nga Dorëzanësi Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963 në favor të blerësit Bledar Rakip Vorpsi i datëlindjes 22.06.1971.

IV. Kundër vendimit lejohet ankim brenda 5 ditëve, nga marrja dijani në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

V. Për veprimet ose mosveprimet tuaja na vini në dijeni brenda afateve ligjore.

**Bashkëngjitur, njëhsuar me vulën e përmbaruesit gjyqësor, po ju dërgojmë:**

- A) Titulli Ekzekutiv Deklaratë Noteriale, nr.2499 Rep, nr.843 Kol, datë 17.06.2013, redaktuar nga Notere Flutura Abdiu.
- B) Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi nr.(11-2014-)1050, datë 24.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- C) Urdhëri për vendosjen e masës së sekuestros konservative të kuotave të kapitalit në vlerën prej 2% me nr. 1104/prot; 225-Regj, datë 16.11.2017.
- D) Kopje e procesverbalit të Ankandit të Dytë, të mbajtur në datë 06.04.2022.
- E) Kopje e kartës së identitetit të Blerësit Bledar Rakip Vorpsi i datëlindjes 22.06.1971.

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**LEKË D. DODAJ**



2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVAT  
PËRMBARUESI GJYQËSOR "LEKË DODAJ"

Adr: Rr. "Astrit Balluku", Nd. 2, H. 25, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, E-mail: [leke\\_dodaj@hotmail.com](mailto:leke_dodaj@hotmail.com), Cel: +355 67 39 00 666

Nr. 369 /Prot; 225- Regj

Tiranë, më 07 / 04 /2022

URDHËR

*"Për heqje të masës së sekuestros konservative"*

Drejtuar : Qëndrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë

Për dijëni : Dorëzanësit, Milazim Kabashi  
Lagjia e Re, pranë Xhamisë, Shkallnur, Durrës

**Pala Debitore Shoqëria "ADNAIN" sh.p.k me NIPT K01608501Q**  
Njësia Bashkiake nr.5, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake,  
Kulla, nr.2, Kati 4, Zyra A1, Tiranë.

**Palës Kreditore, Bardhyl Mara, përfaqësuar me Prokurë të**  
**Posacme me nr.5321 Re, nr.3536 Kol nga Z.Shyqyri Ahmeti.**  
Rruga "Pavarësia "Durrës

Unë, Lekë Dodaj Përmbartes Gjyqësor Privat me Çertifikatë Nr.144 Mars 2013 dhe NIPT L31603014T, bazuar në Titullin Ekzekutiv Deklaratë Noteriale, nr.2499 Rep, nr.843 Kol, datë 17.06.2013, redaktuar nga Notere Flutura Abdiu për të cilin është lëshuar për zbatim Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi nr.(11-2014-)1050, datë 24.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës,

**KONSTATOVA :**

Se me datë 24.04.2016, është depozituar pranë Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Lekë Dodaj kërkesa e Palës Kreditore Bardhyl Mara, së bashku me Titullin Ekzekutiv Deklaratë Noteriale, nr.2499 Rep, nr.843 Kol, datë 17.06.2013, redaktuar nga Notere Flutura Abdiu për të cilin është lëshuar për zbatim Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi nr. (11-2014-)1050, datë 24.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me palë dhe objekt :

**Kreditor : Bardhyl Mara**  
**Debitor : Shoqëria "ADNAIN" sh.p.k me NIPT K01608501Q**  
**Dorëzanës : Milazim Kabashi**  
**Objekti : Kthim shume**

Pasi kanë kaluar afatet e parashikuara në nenin 517, 518 të K.Pr.Civile, ekzekutimi i Urdhërit të Ekzekutimit ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe Përmbaruesi Gjyqësor ka vijuar praktikën përbarimore në zbatim të Deklaratës Noteriale, nr.2499 Rep, nr.843 Kol, datë 17.06.2013, redaktuar nga Notere Flutura Abdiu për të cilin është lëshuar për zbatim Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi nr. (11-2014-)1050, datë 24.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës , për efekt të shlyerjes së detyrimit financiar .

Më datë 06.04.2022 , pranë Shërbimit Përbarimor të Përmbaruesit Gjyqësor Lekë Dodaj është zhvilluar Ankandi i Dytë , nga ku është shpallur fitues Ofertuesi Bledar Rakip Vorpsi i datëlindjes 22.06.1971, i identifikuar me letërnjoftimin nr. H10622146K i cili dha ofertën përfundimtare në vlerën 7'000'000 ( shtatë milionë) Lekë për sendin e luajtshëm kuota të kapitalit në vlerën prej 2% që zotërohen nga Dorëzanësi Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963, i cili është në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q, e cila ka si objekt të saj ndërtime civile dhe industriale si dhe investime në TEC dhe HEC , me seli qendrore të ndodhur në Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla, nr.2, Kati 4, Zyra A1, Njësia Bashkiake nr.5, Tiranë.

**Për sa më sipër, të ndodhur në kushtet kur kuotat e kapitalit në vlerën 2% që zotëroheshin nga Dorëzanësi Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963, janë tjetërsuar tashmë sipas ligjit, në zbatim të nenit 617 të K.Pr.Civile,**

### **URDHËROJ:**


**I.**Qëndrën Kombëtare të Biznesit, të heqë masën e sekuestros konservative mbi 2 % e kuotave të kapitalit që zotëron Dorëzanësi Milazim Sadri Kabashi i datëlindjes 01.06.1963, në cilësinë e ortakut në Shoqërinë Adnain sh.p.k, me NIPT K01608501Q, të vendosur me urdhërin e Shërbimit Përbarimor me nr. 1104/prot; 225-Regj, datë 16.11.2017 , pasi sendi i luajtshëm i sipërcituar është tjetërsuar me shitjen në ankand sipas ligjit , për efekt të shlyerjes së detyrimit financiar sipas Titullit të Ekzekutimit , dhe tashmë ka një tjetër pronar.

**II.**Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni shkresërisht brenda 10 (dhjetë) ditëve që është afati ligjor.

**III.**Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.III) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzim penal parashikuar nga neni 320/a.

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**LEKË D. DODAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT  
DREJTORIA E KËRKIMIT DHE UDHËHEQJES  
METODOLOGJIKE

95811  
Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më 12.04.2022

Lënda: Kthim përgjigje

**PËRMBARUES GJYQËSOR "LEKË DODAJ"**

Rr. "Astrit Balluku", Nd.2, H.25, pranë Gkykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë

Pranë QKB është protokolluar me nr. 9581 Prot, datë 07.04.2022, shkresa juaj me lëndë "Vendim për kalim sendi të luajtshëm në pronësi".

Nga marja në shqyrtim e shkresës tuaj, në pjesën e dispozitivit është vendosur kalimi i pronësisë së kuotave të kapitalit në vlerën prej 2% që zotërohen nga pronari i mëparshëm Milazim Kabashi, në cilësinë e ortakut në shoqërinë "Adnani" shpk, me NUIS/NIPT K01608501Q, në emër të blerësit fitues të ankandit z. Bledar Vorpsi.

Ndërkohë, nga verifikimi i kryer në regjistrin tregtar rezulton se në subjektin "Adnani" shpk, me NUIS/NIPT K01608501Q, në çështjen me nr. CN-874736-03-22, datë 10.03.2022 është depozituar urdhri Nr. 49/4 Regj., Nr.63 Prot., datë 01.03.2022, lëshuar nga Zyra Përmbarrimore "DIT", me përmbarruese Gjyqësore "Suela Methoxha", protokolluar nga QKB me Nr.6450 Prot., datë 04.03.2022, ku është urdhëruar: Vendosja e masës së sekuestros konservative në aksionet që zotërohen nga debitori Milazim Kabashi në shoqërinë "ADNAIN" shpk me NUIS (NIPT) K01608501Q.

Sa më sipër, në mënyrë që QKB të depozitojë shkresën tuaj Nr. 368 Prot, datë 07.02.2022, për kalimi e pronësisë së kuotave të kapitalit në vlerën prej 2% që zotërohen nga pronari i mëparshëm Milazim Kabashi, duhet të depozitohet shkresa nga zyra përmbarrimore "DIT", me përmbarruese Gjyqësore "Suela Methoxha", për heqjen e sekuestros ose lejimin e kalimit të pronësisë së kuotave të zotëruara nga z. Milazim Kabashi.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Pranvera Fagu (Bebushi)



# DIT



ZYRA PËRMBARIMORE  
"DIT"  
PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA

Adresa: L.2, Rr. "Aleksandër Goga", pranë Gjykatës së Rrethit, Kati 2-te, Durrës email: methoxha.suela@gmail.com Cel.0673000088

Nr.49, Regj.  
Nr. 130 Prot

Durrës, më 28.04.2022

## URDHËR PËR HEQJEN E SEKUESTROS

Drejtuar: QËNDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

TIRANË

Për dijëni debitorit: Milazim Sadri Kabashi lindur më 01.06.1963 në Zahrisht, Kukës, identifikuar me kartë identiteti nr.G30601340D banues në Lagjja e Re, Shkallnur, Durrës

kreditorit: Xhoana Skënder Nooder (Uka mbiemri i vajzërisë), lindur më 11.02.1978, lindur në Kukës, banuese në 45143 Essen, Huttmanstr.76, Gjermani, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga Shadete Uka.

Përmbauesit Gjyqësor "Lekë Dodaj" me adresë Rr. "Astrit Balluku", Nd.2, H.25, Tiranë

Në Durrës, sot në datë 28.04.2022

Unë Përmbauese Gjyqësore SUELA METHOXHA pasi studiova materialet e dosjes përmbaimore me Nr.49 Regj, në zbatim të "Urdhërit të Ekzekutimit" Nr.(11-2021-8342)2352 dt.14.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.


### KONSTATOVA

Se në datë dt. 28.01.2022 është depozituar kërkesa e palës kreditore, pranë Zyrës Përmbaimore "DIT" së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit Nr.(11-2021-8342)2352 dt.14.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me palë:

- Kreditor: Xhoana Skënder Nooder (Uka mbiemri i vajzërisë) përf.me prokurë të posaçme nga Shadete Uka
- Debitor: Milazim Sadri Kabashi
- Objekti: Kthim shume

Për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit, është kryer sekuestro konservative duke mos lejuar tjetërsimin e aksioneve të debitorit Milazim Sadri Kabashi, me urdhërin Nr.49/4 Regj, Nr.63 Prot datë.01.03.2022.

Për sa më lart, bazuar në kërkesën e Përmbauesit Gjyqësor "Lekë Dodaj" me nr.465 Prot:225 Regj datë.28.04.2022, si dhe ligjit Nr.26/2019 "Për Shërbimin Përmbaimore Privat",



**URDHËROJ**

1-**HEQJEN** e masës së sekuestros mbi aksionet që zotërohen nga pala debitorë Kabashi lindur më 01.06.1963 në Zahrisht, Kukës në shoqërinë:


- “ADNAIN” sh.p.k pajisur me Nipt K01608501Q

2-Për veprimet apo mosveprimet tuaja , na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor 5-ditor.

3- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe nenit 320 të Kodit Penal.

4-Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve.

**PËRMBARUESE GJYQËSORE  
SUELA METHOXIA**



LETËR E POROSITUR Nr. 49 Regj Dt. 28.04.2022

Nr. 130 Prot DREJTUAR

**DIT**

DËRGON: STUDIO PËRMBARIMORE

PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA


Adresa: L.2, Rr. "Aleksandër Goga", pranë Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

QKB

B/bl. "Zhan D'Ark"

Tirane



VËRTETOHET KOMUNIKIMI DT. \_\_\_\_\_

POSTIERI

MARRËSI

*Esela*